VENDIM
Nr. 265, datë 27.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 4.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË KËSHILL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Pranë KKP-së krijohen dhe funksionojnë komisionet e përhershme e të specializuara tripalëshe, me përbërje, si më poshtë vijon:

a) Komisioni juridik kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Drejtësisë:

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. shoqata "Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë".

b) Komisioni i punësimit, arsimit dhe formimit profesional kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës sektori i PAFP-së;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata e Bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave.

c) Komisioni i pagave, pensioneve dhe përkrahjes sociale kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Pensioneve dhe Pagës Minimale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve/Këpucëve-Proeksport.

ç) Komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurimit në punë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Marrëdhënieve të Punës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. ISHPSHSH-ja, nëndrejtori;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

d) Komisioni i ekonomisë dhe i financës kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit i dhe Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjësi i sektorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Borxhit;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata Shqiptare e Bankave.

dh) Komisioni i shanseve të barabarta, aftësive të kufizuara dhe rinisë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë Përgjegjëse për Shanset e Barabarta dhe Aftësitë e Kufizuara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Arsimit dhe Sportit, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për rininë;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata Shqiptare e Turizmit.”.

2. Pika 11 shfuqizohet.

II. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Belinda Balluku